

Në bazë të nenit 42 paragrafit (2) të Ligjit për Arsimin Fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 161/19, 229/20, 3/25 dhe 74/25), ministrja e Arsimit dhe Shkencës solli

## **RREGULLORE**

### **PËR MËNYRËN E REALIZIMIT TË EKSKURSIONEVE, DALJEVE DHE AKTIVITETEVE TË TJERA JASHTËSHKOLLORE TË NXËNËSVE NGA SHKOLLAT FILLORE**

#### **I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1**

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e kryerjes së ekskursioneve, daljeve dhe aktiviteteve të tjera jashtëshkollore të nxënësve nga shkollat fillore.

##### **Neni 2**

Me këtë rregullore mbulohen aktivitetet e mëposhtme jashtëshkollore të nxënësve: dalje, ekskursion, mësim në natyrë, kampe/shkola verore dhe dimërore.

##### **Neni 3**

Ekskursionet, daljet dhe aktivitetet e tjera jashtëshkollore të nxënësve të cilët i organizojnë shkollat fillore janë aktivitete edukativo-arsimore të cilat realizohen jashtë shkollës me qëllim zgjerimin dhe thellimin e njohurive të nxënësve nga fusha dhe lëndë të caktuara edukativo-arsimore, si dhe arritjen e qëllimeve të tjera edukative, arsimore dhe rekreative.

##### **Neni 4**

Qëllimet e ekskursioneve shkollore, daljet dhe aktivitetet e tjera jashtëshkollore realizohen nëpërmjet:

- hulumtim i objekteve dhe fenomeneve në natyrë, si dhe marrëdhënieve në jetën shoqërore;
- vizitave në lokalitete dhe objekte me rëndësi kulturore, historike dhe të tjera;
- zhvillimit të interesit për natyrën dhe ndërtimit të zakoneve ekologjike;
- njohjes me kulturën dhe mënyrën e jetesës së njerëzve në pjesë të ndryshme të vendit;
- ndërtimit të ndjenjës së përkatësisë ndaj vendit, identitetit, tolerancës dhe bashkëjetesës;
- prezantimit të nxënësve me kulturën e bashkësive të ndryshme etnike të cilët jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (përmes përzgjedhjes së objekteve kulturore dhe historike që do të vizitohen) për zbatimin e integritetit ndëretnik në arsim;
- zhvillimit të marrëdhënies pozitive ndaj vlerave kombëtare, kulturore dhe estetike të popullit të vet dhe qytetarëve të cilët u përkasin popujve të tjerë të cilët jetojnë në vend;

- shoqërimit, socializimit, mbrojtjes kolektive dhe fitimit të përvojës në pavarësi dhe kujdes për veten dhe
- zhvillimit të interesit për aktivitete sportive, rekreacionit dhe krijimit të zakoneve për jetë të shëndetshme shoqërore.

### **III. PLANIFIKIMI, PROGRAMIMI DHE KUSHTET PËR ORGANIZIMIN DHE REALIZIMIN E EKSKURSIONEVE, DALJEVE DHE AKTIVITETEVE TË TJERA JASHTËSHKOLLORE TË NXËNËSVE NGA SHKOLLAT FILLORE**

#### **Neni 5**

Me pogramin vjetor të punës së shkollës përfshihen: plani, programi/përmbajtja, kushtet për organizimin dhe për realizimin e ekskursioneve, daljeve dhe aktiviteteve të tjera jashtëshkollore të nxënësve nga shkollat fillore.

#### **Neni 6**

Në bazë të programit vjetor të punës së shkollës, përgatitet Program për ekskursione, dalje dhe aktivitete të tjera jashtëshkollore të nxënësve.

Bordi i shkollës me vendim formon ekip të posaçëm profesional për të përgatitur Programin për ekskursione, daljet dhe aktivitetet e tjera jashtëshkollore të nxënësve nga shkollat fillore. Ekipi profesional përbëhet nga: drejtori i shkollës, përfaqësues nga shërbimi profesional i shkollës, udhëheqësit e klasave ose mësimdhënësit e tjerë të cilët realizojnë mësim në shkollë për të paktën një vit shkollor.

Drejtori i shkollës emëron udhëheqës të ekskursionit, daljes dhe aktiviteteve të tjera jashtëshkollore nga radhët e mësimdhënësve të cilët realizojnë mësim në klasat me të cilat do të kryhet ekskursioni ose aktiviteti tjetër jashtëshkollor.

Programi për ekskursione, dalje dhe aktivitete të tjera jashtëshkollore të nxënësve të shkollës fillore duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

- sa dhe çfarë lloj ekskursionesh, dalje dhe aktivitete të tjera jashtëshkollore janë planifikuar, për të cilët nxënës (cilës klasë) është dedikuar secila prej tyre;
- qëllimet edukativo-arsimore, ku qëllimet duhet të specifikohen në secilin program varësisht nga lloji i ekskursionit, daljet dhe aktiviteteve të tjera jashtëshkollore dhe mosha e nxënësve;
- përmbajtja dhe përshkrimi i aktiviteteve;
- mësimdhënësi përgjegjës, mësimdhënësi të tjerë të përfshirë;
- nxënësit e përfshirë në aktivitet;-
- kohëzgjatja;
- monitorimi i realizimit;
- lokacione për vizita dhe shqyrtim
- relacionet e udhëtimit
- orari i mësimit (për edukim në natyrë);
- kodi i sjelljes së nxënësit;
- organizimi teknik dhe

- mënyra e financimit.

- Për përgatitjet me karakter profesional-pedagogjik, teknik-organizativ dhe të sigurisë gjatë realizimit të ekskursioneve, daljeve dhe aktiviteteve të tjera jashtëshkollore, në shkollë kujdeset ekipi profesional nga paragrafi 2 të këtij neni.

- Programet për daljet, ekskurzionet dhe aktivitete të tjera jashtëshkollore të parashikuara në programin vjetor për punën në shkollë, publikohen në tabelën e njoftimeve dhe në ueb-faqen e shkollës.

#### Neni 7

Gjatë organizimit dhe realizimit të mësimave që zgjasin më pak se 180 ditë shkollore, si dhe realizimin të mësimave sipas programeve mësimore të shkurtuara në kushte të rrethanave të jashtëzakonshme (ekzistencë e përcaktuar e situatës krize, epidemi e shpallur, gjegjësisht pandemi, zjarre, përmbytje ose fatkeqësi të tjera të mëdha natyrore), ose gjatë organizimit të mësimave përmes mësimit në distancë, shkolla nuk duhet të përgatisë Program për dalje, ekskursione dhe aktivitete të tjera jashtëshkollore.

Nëse këshilli i shkollës ka miratuar një Program për ekskurzione, dalje dhe aktivitete të tjera jashtëshkollore para shpalljes së rrethanave të jashtëzakonshme nga paragrafi 1 i këtij neni, e njëjta pezullohet për atë kohë sa zgjasin rrethanat e jashtëzakonshme.

#### Neni 8

Gjatë organizimit dhe realizimit të mësimave që zgjasin më pak se 180 ditë shkollore, si dhe realizimin e mësimave sipas programeve të shkurtuara në kushte të rrethanave të jashtëzakonshme (ekzistencë e përcaktuar e situatës së krizës, epidemi e shpallur, gjegjësisht pandemi, zjarre, përmbytje ose fatkeqësi të tjera të mëdha natyrore) ose gjatë organizimit të mësimave përmes mësimit në distancë, shkolla mund të planifikojë dhe organizojë dy dalje njëditore me nxënës gjatë vitit shkollos, në vjeshtë dhe pranverë, ndërsa të njëjtit duhet të zhvillohen në kohëzgjatje deri në pesë orë për të arritur qëllime sportive-rekreative, edukative dhe arsimore.

Ekskurzionet në paragrafin 1 të këtij neni duhet të organizohen në distancë deri në dy kilometra nga shkolla, pa përdorur transportin publik.

Daljet organizohen në nivel klase, por jo më shumë se dy klasa në të njëjtën ditë, në të njëjtin vend.

Gjatë organizimit të daljeve të gjitha respektohen të gjitha protokollet dhe rekomandimet në përputhje me kushtet në të cilat ato organizohen.

Plani dhe organizimi i daljeve miratohen nga këshilli i shkollës.

#### Neni 9

Ekipi profesional përgatit Kodeks për sjellje të nxënësit gjatë ekskursioneve shkollore, daljeve dhe aktiviteteve të tjera jashtëshkollore (në tekstin e mëtejshëm: Kodeksi).

Kodeksi përmban:

- respektimin e detyrueshëm të ligjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- përfaqësimin e denjë të shkollës, qytetit tuaj;
- ndalimin e konsumimit të alkoolit dhe substancave të tjera të paligjshme;
- ndalimin e prishjes së rendit dhe qetësisë publike, sjelljes së dhunshme dhe shkakimit të dëmeve materiale dhe
- ndalimin e distancimit nga grupi.

Në bazë të Kodeksit, prindi/kujdestari i nxënësit nënshkruan deklaratë se gjatë kryerjes së ekskursioneve, daljeve dhe aktiviteteve të tjera jashtëshkollore do t'i respektojnë dispozitat e Kodeksit. Deklarata e nënshkruar i dorëzohet udhëheqësit të klasës/udhëheqësit të paralelës, më së voni tre ditë para realizimit të ekskursioneve, daljeve dhe aktiviteteve të tjera jashtëshkollore.

Nxënësit që gjatë ekskursionit shkollor, daljeve dhe ekskursioneve e tjera jashtëshkollore nuk e respekton Kodeksin, këshilli i mësimdhënësve i ndaon pjesëmarrje në ekskursionet shkollore të ardhshme, daljet në natyrë dhe aktivitetet e tjera jashtëshkollore dhe propozon që t'i shqiptohet masë pedagogjike.

### **Neni 10**

Për çdo Program për ekskursione, dalje dhe aktivitete të tjera jashtëshkollore të nxënësve të shkollave fillore, të cilat përgatiten nga ekipi profesional, mendim jep Këshilli i Prindërve të Shkollës. Mendimet mbi ekskursionet, daljet dhe aktivitetet e tjera jashtëshkollore nga Këshilli i Prindërve të Shkollës i dorëzohen shkollës më së shumti pesë ditë nga dita e dorëzimit nga ekipi.

Mendimet mbi ekskursionet, daljet dhe aktivitetet e tjera jashtëshkollore nga Këshilli i Prindërve të Shkollës dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës i dorëzohen shkollës më së voni pesë ditë nga dita e dorëzimit nga ekipi.

Bazuar në mendimet nga paragrafi 1 të këtij neni, këshilli i shkollës miraton çdo program për ekskursione, dalje dhe aktivitete të tjera jashtëshkollore për nxënësit e shkollës fillore më së voni në afat prej 20 ditëve nga sjellja e mendimeve nga Këshilli i prindërve.

### **Neni 11**

Ekskursioni shkollor realizohet pasi të jetë marrë miratimi për realizimin e ekskursionit nga këshilli i shkollës, pas së cilës ekskursioni organizohet dhe realizohet me pëlqimin me shkrim të të paktën 30% të prindërve të nxënësve në klasë/klasën.

Për nxënësit të cilët nuk marrin pjesë në ekskursion, shkolla organizon mësim.

### **Neni 12**

Mësimet në natyrë organizohen me nxënësit nga klasa e V gjatë punës edukativo-arsimore, gjatë vitit shkollor.

Mësimet në natyrë zhvillohen në përputhje me të paktën 50% të prindërve të nxënësve në klasë.

Objektet në të cilat zhvillohen mësimet në natyrë kanë të paktën një klasë, të pajisur sipas Normativit për hapësirë, pajisje dhe mjete mësimore për arsimin fillor nëntëvjeçar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Për realizimin e drejtpërdrejtë të mësimi në natyrë, përgjegjës është udhëheqësi i klasës së paraleles.

Për nxënësit që nuk ndjekin mësimet e natyrës, shkolla organizon mësimet në shkollë.

Për nxënësit me vështirësi, mësimet në natyrë organizohen me shoqërim, në përputhje me llojin dhe shkallën e vështirësisë, ku në shoqërim mund të jetë: prind/kujdestar, asistent, edukator special dhe rehabilitues.

### **Neni 13**

Kamper/shkollat verore dhe dimërore organizohen dhe zhvillohen për nxënësit nga klasat I deri në IX gjatë pushimeve shkollore verore dhe dimërore në kuadër të shkollës dhe jashtë saj.

Për nxënësit me vështirësi, shkollat verore dhe dimërore organizohen me shoqërim, në përputhje me llojin dhe shkallën e vështirësisë, ku shoqëruar mund të jetë: prind/kujdestar, asistent, edukator special dhe rehabilitues.

Kamper/shkollat verore dhe dimërore organizohen dhe zhvillohen në objekte të cilët kanë të paktën një klasë, të pajisura sipas Normativit për hapësirë, pajisje dhe mjete mësimore për arsimin fillor nëntëvjeçar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

### **Neni 14**

Për nxënësit nga familjet në gjendje të vështirë sociale, të cilët nuk mund të marrin pjesë në ekskursione shkollore, drejtori mund të sigurojë pjesëmarrjen e tyre me shfrytëzimin e lehtësimit që ofron agjencia e cila merr pjesë në realizimin e aktiviteteve të përmendura ose nga burimet vetjake të shkollës, donacione, sponsorime dhe burime të tjera të shkollës.

## **IV. ORGANIZIMI DHE ZBATIMI I EKSKURSIONEVE, DALJEVE DHE AKTIVITETEVE TË TJERA JASHTËSHKOLLLORE TË NXËNËSVE TË SHKOLLAVE FILLORE**

### **Neni 15**

Ekskursionet, daljet dhe aktivitetet e tjera jashtëshkolllore të nxënësve të shkollave fillore për të gjithë nxënësit të së njëjtës klasë në shkollë organizohen njëkohësisht, me të njëjtën përmbajtje dhe të njëjtat aktivitete.

Për nxënësit me vështirësi, të përfshirë në shkollat fillore, ekskursionet, dalje dhe aktivitetet e tjera jashtëshkolllore organizohen njëkohësisht, ndërsa përmbajtja dhe aktivitetet përshtaten varësisht nga lloji dhe shkalla e vështirësisë, afinitetet individuale, nevojat dhe mundësitë e nxënësve.

Ekskursionet, daljet dhe aktivitetet e tjera jashtëshkolllore për të gjithë nxënësit me nevoja të veçanta arsimore nga shkollat fillore me qendër burimesh organizohen njëkohësisht, me

përmbajtje dhe aktivitete të ndryshme varësisht nga lloji dhe shkalla e vështirësisë, si dhe nga afinitetet, nevojat dhe aftësitë individuale të nxënësve.

## Neni 16

Ekskursionet, daljet dhe aktivitetet e tjera jashtëshkollore të nxënësve të shkollave fillore do të organizohen dhe zhvillohen në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## Neni 17

- Për realizimin e ekskursioneve, shkollat, në përputhje me qëllimin dhe kohëzgjatjen e tyre, zgjedhin disa nga vendet, lokalitetet dhe objektet në vazhdim:
- **Berovë:** Liqeni i Berovës, Manastiri "Shën Kryeengjëlli Mihail", Muzeu i Qytetit të Berovës.
- **Manastir:** Heraklea, Muzeu Natyroro-shkencor - Manastir dhe Parku Kombëtar "Pelister", Muzeu Historik - Manastir, Muzeu i Alfabetit Shqip - Manastir, Dhoma përkujtimore e Mustafa Kemal Atatürkut.
- **Vinicë:** Kalaja e Vinicës, Muzeu i Terrakotës.
- **Vevčanë:** Burimet e Vevčanit.
- **Veles:** Liqeni i Velesit, Kostrona Përkujtimore, Muzeu i Qytetit të Velesit, Shtëpia përkujtimore e Koço Racinit.
- **Gjevgjeli:** Vardarski Rid;
- **Gostivar:** Burimi i lumit Vardar "Vrutok", Begova Kuqa, Sahat Kulla;
- **Dibër:** HEC "Spilje", Banja e Kosovrës, Kanioni i Radikës, shtëpia tradicionale shqiptare (shtëpia e familjes Erebara), Manastiri i Bigorsit "Shën Jovan Kërstitell", Manastiri "Shën Gjergji Fitimtari" - Rajçicë.
- **Delçevë:** Ekspozita arkeologjike-etnologjike e artefakteve nga Rajoni i Pijanecit (Shtëpia e Kulturës në Delçevo) dhe Shtegu i biodiversitetit përgjatë pellgut të lumit Bregallnica; mali Golak me përmbajtjet e manastirit "Shën Panteleimoni" dhe Shtegu i bimëve; Shtëpia përkujtimore e Kryengritjes së Razllovçës – fshati Razllovçë.
- **Dojran:** Liqeni i Dojranit.
- **Kavadarci:** "Stobi", "Feni", HEC "Tikveš", Monumenti përkujtimor "12 të rinjtë e Vatares", Shtëpia përkujtimore e Strasho Pinxhurit, Muzeu i qytetit të Kavadarci, parku i qytetit – Varreza përkujtimore.
- **Kërçovë:** Manastiri "Shën Bogorodica – Preçista", Shtëpia e Artit, Muzeu i qytetit të Kërçovës, Kalaja, Monumenti përkujtimor "Nëna" – Zajas, burimi i lumit Treska.
- **Koçan:** Monumenti i lirisë, Kompleksi manastiror Shën Pantelejmon, Monument përkujtimor në fshatin Svilanovë (vdekja e Nikolla Karevit), Shtëpia etnografike, diga "Gradçe" dhe lumi i Koçanit.
- **Kratovë:** Golemo Gradishte, Konjuh.
- **Kriva Pallankë:** Manastiri "Shën Joakim Osogovski", Qendra turistike malore "Kalin Kamen" (Malet e Osogovës), Kalaja e Kriva Pallankës, Varreza përkujtimore.
- **Krushevë:** Shtëpia përkujtimore e Todor Proeskit, monumenti "Makedonium", monumenti "Guri i arushës", Galeria e Nikolla Martinoskit, kisha "Shën Nikolla".
- **Kumanovë:** Observatori "Kokino" dhe Guri i Njeriut.
- **Mavrovë:** Qendra dimërore rekreative "Mavrovë" dhe Qyteti i Borës.
- **Makedonski Brod:** Shpella "Peshna".

- **Negotinë:** TEC "Negotinë".
- **Ohër:** Lihnidos, Qyteti i Vjetër, Teatri Antik, Plaoshniku dhe Kalaja e Samoilit, Kisha "Shën Sofia" - Ohër, Kisha "Shën Bogorodica Perivlepta", Kisha "Shën Jovan Bogoslov" - Kaneo, Manastiri "Shën Naumi i Ohrit", Vendbanim me shtylla "Qyteti i Ujit", Instituti Hidrobiologjik, Burimet Biljanini dhe Aeroporti i Ohrit.
- **Pehçevë:** Ujëvarat në vendbanimin turistik Ravna Reka - Pehçevë; Qendra Edukative për Ruajtjen e Natyrës në Rajonin e Bregallnicës në fshatin Negrevë - Komuna e Pehçevës dhe lokaliteti arkeologjik dhe manastiri "Shën Petka";

- **Prilep:** Qyteti i Epërm dhe Markovi Kuli, Manastiri "Sveto Preobrazhenie" në Zërze, Manastir "Uspenie na Presveta Bogorodica" në Treskavec, Manastir "Shën Nikollë" - Manastiri i fshatit, Mariosë, Manastiri "Shën Arkangjel Mihail" - Varosh shtëpia "Konjësi i Bllaçit" në fshatin Varosh të Nebregovës.

- **Probishtip:** Manastir "Gavril Lesnovski" - f. Lesnovë.

- **Resnjë:** Kisha "Shën Gjergji" - Kurbinovë, pallati në Resnjë, Muzeu i qytetit të Resnjës, Liqeni i Prespës.

- **Shkup:** Kanioni i Matkës, Manastir "Fjetja e Virgjëreshës së Bogorodicës" - Matkë, Manastiri "Shën Pantelejmon" - Nerez i Epërm, Manastiri "Shën Andrea" - Matkë, Manastiri i Markovit, Skupi Instituti për Trashëgimi Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve - Shkup, Viadukti Romak, Vendndodhja Arkeologjike "Tumba Maxhari", Kalaja e Shkupit, Çarshia e Vjetër, Aeroporti i Shkupit, Shtëpia Përkujtimore e Nënë Terezës, Muzeu Arkeologjik, Muzeu i Luftës Maqedonase, Qendra Përkujtimore e Holokaustit të Hebrenjve të Maqedonisë, Kisha "Shën Spasi" (vendi i prehjes së Goce Delçevit) - Shkup, Muzeu i Historisë Natyrore dhe Kopshti Zoologjik;

- **Strugë:** Muzeu i Historisë Natyrore, Shtëpia Përkujtimore e "Vëllezërve Miladinovci", Muzeu Etnologjik "Via Kandavija" në f. Livadishtë, Xhamia "Mustafa Çelebi" dhe Manastiri "Shën Bogorodica" (f. Kalishtë), Strugë.

- **Strumicë:** Ujëvarat e Koleshinskit dhe Ujëvarat e Smolarskit, Manastir "Fjetja e Nënës së Bekuar" - Eleusa, Manastiri "Shën Leontij" - Vodoça.

- **Tetovë:** Xhamia e Larme dhe Kalaja e Tetovës, Manastiri i Lesocit "Shën Athanasij", Teqeja Arabati Baba - Tetovë; Shtëpia e Jovanovci-t - Tetovë, Muzeu i Qytetit të Tetovës, Qendra Rekreative Dimërore "Popova Shapka".

- **Shtip:** Muzeu i Qytetit të Shtipit (1. Ekspozitë Historike; 2. Ekspozitë Arkeologjike; 3. Muzeu i VMRO-së për Shtipin dhe Shtipit), Vendndodhja Arkeologjike "Bargala", Isar, Kisha "Shën Nikolla", Kisha "Shën Bogorodica" - Novo Selë.

**Lokacionet e Rrjetit për të mësuarit nkluziv (miu.mk) dhe parqet nacionale në mbarë vendin:** (Kopshti Botanik pranë Fakultetit të Shkencave Matematiko - Natyrore në Shkup; ISHP Instituti Hidrobiologjik Publik – Ohër; Teknika Popullore, Shkup; Qendra Edukative për Mbrojtjen e Natyrës, fshati Negrevo, Pehçevë; Laboratori Bioteknologjik, Shkup; Parku i Natyrës Ezerani pranë Shoqatës Ekologjike të Maqedonisë, Resnjë; Parku Kombëtar Pelister; Parku Kombëtar Mavrovë; Parku Kombëtar Galiçicë; Parku Kombëtar Sharr dhe të tjerë).

Gjatë ekskursionit ndalohet vizita në vende, lokalitete dhe objekte të tipit: parqe argëtimi, akvaparkë, ngjarje sportive, ngjarje muzikore, festa, diskoteka dhe të ngjashme, si dhe vende të cilat mund të paraqesin rrezik për sigurinë ose nuk janë të përshtatshme për moshën, interesat dhe qëllimet edukativo-arsimore të nxënësve.

Shkolla mund të propozojë edhe lokacion tjetër për ekskursion, me arsyetim të argumentuar për zgjedhjen e lokacionit. Lokacioni i propozuar i dorëzohet themeluesit të shkollave themelore komunale dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për shkollat fillore shtetërore, pas së cilës merr mendim pozitiv, lokacioni bëhet pjesë e Programit për ekskursione, dalje dhe aktivitete të tjera jashtëshkollore të nxënësve të shkollës fillore të cilën e propozon lokacioni.

Ekskursionet për nxënësit me vështirësi nga shkolla fillore me qendër burimore organizohen dhe realizohen në vende, lokalitete dhe objekte të cilat nuk janë të kufizuara nga rajonet e caktuara, gjegjësisht realizohen në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me qasjen në terren.

#### **Neni 18**

Vizita e lokaliteteve nga neni 17 i kësaj rregullore nuk përsëritet me nxënës që tashmë e kanë vizituar lokalitetin e përzgjedhur.

#### **Neni 19**

Shkolla organizon dalje për të gjithë nxënësit, më së shumti dy herë gjatë vitit shkollor, në vjeshtë dhe në pranverë, dhe realizohen në rrethinën më të afërt, me kohëzgjatje deri në një ditë, për realizimin e qëllimeve sportive-rekreative, edukative dhe arsimore.

Daljet për nxënësit nga klasa I deri në klasën III realizohen deri në 30 kilometra larg nga komuna në të cilën ndodhet shkolla fillore, ndërsa për nxënësit nga klasa IV deri në klasën IX deri në 50 kilometra larg nga komuna përkatëse në të cilën ndodhet shkolla fillore për realizimin e qëllimeve edukative dhe arsimore.

Për nxënësit me vështirësi, daljet organizohen me përcjellje, në përputhje me llojin dhe shkallën e vështirësisë, ku përcjellës mund të jetë: prindi/kujdestari, asistenti, edukatori dhe rehabilituesi special.

Shkolla organizon ekskursion një herë gjatë vitit mësimor, me kohëzgjatje nga një deri në tre ditë, edhe atë:

për nxënësit e klasës III – një ditë;

për nxënësit e klasës VI – dy ditë;

për nxënësit e klasës IX – tre ditë.

Për shkollat me numër më të vogël të nxënësve, ekskursionet mund të realizohen njëkohësisht me nxënës nga klasa e VI dhe IX, me kohëzgjatje prej dy deri në tre ditë.

Për nxënësit me vështirësi, ekskursionet organizohen me përcjellje, në përputhje me llojin dhe shkallën e vështirësisë, ku përcjellës mund të jetë: prindi/kujdestari, asistenti, edukatori dhe rehabilituesi special.

Përveç ekskursioneve nga paragrafi 4 të këtij neni, shkolla mund të organizojë ekskursion njëditor gjatë vitit mësimor për qëllime edukative dhe arsimore, në përputhje me periudhat

zhvillimore të nxënësve nga klasa I deri në klasën IX, për vizita në institucione dhe manifestime shkencore/edukative, kopsht zoologjik, festival muzikor për fëmijë, panair, teatër, opera, balet, kinema, muze etj.

Mësimi në natyrë organizohet në kohëzgjatje nga tre deri në pesë ditë njëherë në vitin mësimor.

Kampet/shkollat verore dhe dimërore mund të organizohen me kohëzgjatje nga pesë deri në dhjetë ditë.

Për kampet/shkollat verore dhe dimërore është e nevojshme të përgatitet program i veçantë dhe të sigurohen kushte dhe pajisje të përshtatshme.

Për këto forma të aktiviteteve sportive-rekreative, bëhen përgatitje të veçanta për nxënësit, si: përgatitje fizike dhe sigurimi i pajisjeve të përshtatshme, duke marrë parasysh të gjithë faktorët e rrezikut.

## **Neni 20**

Për përzgjedhjen e subjektit juridik për realizimin e ekskursioneve, daljeve dhe aktiviteteve të tjera jashtëshkollore të nxënësve të shkollave fillore, shkolla, në emër të prindërve, realizon procedurë për mbledhjen e ofertave me shpalljen e thirrjes publike në së paku në dy gazeta ditore, prej të cilave së paku në gjuhën maqedonase dhe një në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve që flasin gjuhë të ndryshme nga maqedonishtja. Njëkohësisht, shkolla e vendos shpalljen në vend të dukshëm në hyrje të ndërtesës së shkollës.

Shpallja publike duhet të publikohet me kohë, duke pasur kujdes për respektimin e të gjitha afateve të përcaktuara me këtë rregullore, me qëllim të realizimit në kohë të të gjitha ekskursioneve, daljeve dhe aktiviteteve të tjera jashtëshkollore të planifikuara për nxënësit e shkollave fillore.

Procedura realizohet nga komisioni i formuar me vendim të këshillit të shkollës. Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë, dhe atë: tre anëtarë nga radhët e këshillit të prindërve nga gjenerata e nxënësve për të cilën realizohet ekskursioni dhe dy anëtarë nga radhët e mësimdhënësve. Kryetar i komisionit është një nga anëtarët e këshillit të prindërve.

Komisioni përgatit shpalljen në formë të ftesës për dorëzimin e ofertave, duke përfshirë: përshkrimin e shërbimit; kushtet minimale të cilat duhet të plotësojë ofertuesi; dokumentet të cilat duhet të dorëzojë ofertuesi; informacionet për vlerën e garancisë bankare për realizim cilësor të marrëveshjes, e cila mund të jetë në lartësin prej 5% deri në 15%; afatin e fundit, vendin dhe mënyrën e dorëzimit të të njejtive; si dhe datën e hapjes publike të ofertave. Shpenzimet për publikimin e shpalljes janë në llogari të shkollës.

Përshkrimi i shërbimit përgatitet në përputhje me Programin për ekskursione, dalje dhe aktivitete të tjera jashtëshkollore të nxënësve të shkollës fillore.

Kushtet minimale të cilat duhet t'i plotësojë ofertuesi përgatiten në përputhje me nenin 22 të kësaj rregulloreje.

Afati për dorëzimin e ofertës nuk mund të jetë më i shkurtër se pesë ditë pune.

Komisioni do të fillojë me vlerësimin e ofertave, nëse është pranuar të paktën një ofertë. Komisioni realizon vlerësimin, përgatit raport nga vlerësimi i ofertave dhe jep propozim për përzgjedhjen e ofertuesit më të favorshëm ose propozim për anulimin e procedurës në afat prej pesë ditëve pune nga dita e përcaktuar si afat i fundit për dorëzimin e ofertave. Komisioni mund të jep propozim për anulimin e procedurës në rastet në vijim, dhe atë:

- nëse nuk është parashtruar asnjë ofertë,
- nëse nuk është parashtruar asnjë ofertë e pranueshme,
- nëse çmimet në ofertë janë më të pafavorshme se çmimet reale të tregut.

Këshilli i shkollës në afat prej pesë ditëve, sjell vendim për përzgjedhjen ose vendimin për anulimin e procedurës.

#### **Neni 21**

Në shpalljen për përmbledhjen e ofertave mund të paraqiten persona juridikë të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara në të njëjtën.

Ofertat duhet të përgatiten dhe dorëzohen në përputhje me kërkesat e shpalljes.

Ofertat nuk duhet të përmbajnë zgjidhje alternative, gjegjësisht duhet të jenë të përgatitura konkretisht dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në përshkrimin e shërbimit, e cila është pjesë e ftesës për dorëzimin e ofertës.

Oferta e cila përmban elemente apo shërbime shtesë nuk do të ketë përparësi gjatë vlerësimit të së njëjtës.

Çmimet në oferta duhet të jenë fikse, gjegjësisht nuk lejohet korrigjimi i çmimeve gjatë realizimit të marrëveshjes.

#### **Neni 22**

Kriteri për ndarjen e marrëveshjes për realizimin e ekskursioneve, daljeve ose aktiviteteve të tjera jashtëshkollore për nxënësit e shkollave fillore është çmimi më i ulët.

Kushtet minimale që duhet t'i plotësojë ofertuesi janë:

të jetë i regjistruar në përputhje me dispozitat pozitive në Republikën e Maqedonisë së Veriut për kryerjen e veprimtarisë përkatëse turistike;

të jetë i regjistruar të paktën tre vite para realizimit të ekskursionit, daljeve ose aktiviteteve tjetër jashtëshkollor për nxënësit e shkollave fillore;

të ketë realizuar me sukses programin e tij aranzhues në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

T'i plotësojë kushtet për transport të grupeve të fëmijëve, në përputhje me Ligjin për sigurinë e trafikut rrugor dhe Rregulloren për kërkesa teknike të posaçme të mjeteve lëvizëse me të cilat transportohen grupe fëmijësh.

Kriteret shtesë janë:

Hotelet (sa yje kanë dhe nëse akomodimi është në një apo më shumë hotele në rast se bëhet fjalë për grupe më të mëdha) dhe para-rezervimeve;

Menuja për ushqim;

Bileta të paguara për vizitë në objekte me rëndësi kulturore dhe historike;

Lloji i autobusëve të kategorisë së lartë turistike;

Pagesa me këste (ose deri para nisjes);

Angazhimi i mjekut;

Raste sociale (për sa nxënës do të sigurohet përjashtim nga pagesa);

Shoqërues/udhërrëfyes turistik.

Oferta e ofertuesit e cila nuk i plotëson kushtet minimale do të refuzohet nga komisioni si e papranueshme.

Komisionit nuk i lejohet të përcaktojë kushte minimale dhe kritere shtesë në shpalljen për mbledhjen e ofertave, përveç kushteve dhe kritereve të përmendura në paragrafët e nenit 22.

### **Neni 23**

Ofertuesit e pazgjedhur kanë të drejtë të ankohen, nëpërmjet shkollës fillore komunale, deri te kryetari i komunës, në afat prej tetë ditëve nga dita e marrjes së vendimit për zgjedhjen e ofertës më të favorshme.

Kryetari i komunës formon Komision e cila vendos për ankesat nga paragrafi 1 të këtij neni.

Ofertuesit e pazgjedhur kanë të drejtë të ankohen, nëpërmjet shkollës fillore shtetërore, deri te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në afat prej tetë ditëve nga dita e marrjes së vendimit për zgjedhjen e ofertës më të favorshme.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës formon Komision e cila vendos për ankesën nga paragrafi 3 të këtij neni.

Shkolla, në afat prej tre ditëve nga dita e marrjes së ankesës, me dokumentacionin e plotë nga procedura e realizuar e dorëzon deri te kryetari i komunës, gjegjësisht deri te Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Kryetari i komunës, gjegjësisht ministri i Arsimit dhe Shkencës, vendos për ankesën në afat prej 15 ditëve nga data e marrjes së ankesës.

### **Neni 24**

Udhëheqësit e klasave i informojnë prindërit për shumat financiare të nevojshme për ekskursionet më së voni 10 ditë pas përzgjedhjes përfundimtare të ofertuesit më të favorshëm.

Kjo procedurë zbatohet para lidhjes së marrëveshjes, duke pasur parasysh që në marrëveshje duhet të përfshihet numri i saktë i nxënësve që do të marrin pjesë në ekskursion.

#### **Neni 25**

Drejtori i shkollës lidhë marrëveshje me ofertuesin i cili ofron çmim më të ulët dhe plotëson kriteret e përcaktuara nga neni 22 i kësaj Rregullore për realizimin e ekskursionit, daljeve dhe aktiviteteve të tjera jashtëshkollore.

Marrëveshja e lidhur nga drejtori i shkollës me ofertuesin duhet të përmbajë gjithçka që specifikohet në ofertë, në përputhje me kërkesën për mbledhjen e ofertave, si:

- çmimi individual dhe i përgjithshëm i shërbimit (akomodimi, transporti dhe ushqimi);
- kushtet për akomodim, menyuja për ushqimet dhe transportin;
- çmimi duhet të përfshijë edhe sigurimi i veçant për nxënësit;
- mënyrën e pagesës;
- guidat, numri i mësimitdhënësve, numri i shoqëruesve për nxënësit me vështirësi dhe mjeku;
- përfitimet për nxënësit të cilët vijnë nga familje në nevojë sociale.

Në afat prej 5 ditësh pas nënshkrimit të marrëveshjes, ofertuesi i përzgjedhur dorëzon garanci bankare për realizimin cilësor të ekskursionit, daljeve dhe aktiviteteve të tjera jashtëshkollore në lartësi prej 5% deri në 15% të vlerës së përgjithshme të marrëveshjes.

Pjesë përbërse e marrëveshjes janë kushtet e përcaktuara në ofertë dhe Programi për ekskursione, dalje dhe aktivitete të tjera jashtëshkollore për nxënësit e shkollave fillore.

#### **Neni 26**

Menjëherë para realizimit të udhëtimit, drejtori kontrollon nëse janë siguruar numër i mjaftueshëm i autobusëve me ulëse për akomodim të mirë dhe të sigurt të të gjithë nxënësve.

Udhëtimi nuk duhet të realizohet në periudhën nga ora 22:00 deri në 06:00 të mëngjesit, ndërsa për ekskursionet njëditore të udhëtimit nuk duhet të realizohet në periudhën prej 17:00 deri në 06:00 të mëngjesit.

#### **Neni 27**

Një ditë para realizimit të udhëtimit, nga transportuesi që do të kryejë transportin, drejtori duhet të marrë dëshmi për gjendjen teknike të jashtëzakonshme të mjetit për transport publik, në përputhje me ligjet aktuale në fuqi në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe procesverbal për kontroll teknik të jashtëzakonshëm të autobusit, jo më të vjetër se gjashtë muaj.

Shoferi i autobusit duhet të ketë vërtetim mjekësor jo më të vjetër se gjashtë muaj dhe vërtetim nga personi përgjegjës i transportuesit përderisa nuk ka drejtuar automjet 12 orë para nisjes.

#### **Neni 28**

Drejtori nuk e miraton udhëtimin nëse autobusi nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në lidhje me gjendjen teknike, numrin e nevojshëm të ulëseve dhe nëse autobusi nuk ka sistem klimatizimi.

Drejtori i shkollës, më së voni 48 orë para nisjes së udhëtimit, e informon organin kompetent të punëve të brendshme për:

transportuesin,

vendin dhe kohën e nisjes së nxënësve,

numrin e autobusëve të angazhuar dhe

numrin e nxënësve, mësimitdhënësve dhe personave të tjerë të paraqitur.

Drejtori i shkollës të punësuarve të cilët udhëtojnë me nxënësit në ekskursion, ndërsa për asistentët arsimorë udhëzimin për udhëtim zyrtar, i lëshohet urdhër-udhëtim për udhëtim zyrtar i lëshohet drejtorit të shkollës fillore me qendër burimore.

Nëse nuk janë përmbushur kushtet e lartpërmendura, drejtori i shkollës do ta ndalojë realizimin e ekskursionit, daljet dhe/ose aktivitetet e tjera jashtëshkollore.

#### **Neni 29**

Para realizimit të menjëhershëm, dhe jo më vonë se shtatë ditë para realizimit të ekskursioneve ose aktiviteteve të tjera jashtëshkollore, udhëheqësi i klasës organizon takim me nxënësit dhe prindërit e tyre, në të cilin i informon ata dhe u jep shpjegime të hollësishme për programin që do të zbatohet.

#### **Neni 30**

Udhëheqësit e klasave duhet të marrin të dhëna nga prindërit/kujdestarët për gjendjen shëndetësore të nxënësve dhe për të njëjtit i informojnë mjekun para nisjes.

Të dhënat shëndetësore të nxënësve mbahen konfidenciale.

Nëse gjatë ekskursionit, daljeve dhe aktiviteteve të tjera jashtëshkollore, nxënësi sëmurët ose lëndohet, mjeku është i detyruar të veprojë sipas kompetencës së tij/saj profesionale dhe të kërkojë ndihmë në institucionin më të afërt shëndetësor. Nëse nxënësi mbahet për shërim, me nxënësin duhet të qëndrojë një mësimitdhënës, ndërsa nxënësit e tjerë vazhdojnë udhëtimin.

Udhëheqësi i ekskursionit, daljeve dhe aktiviteteve të tjera jashtëshkollore është i detyruar të njoftojë shkollën dhe prindërit e nxënësit të lënduar ose të sëmurë dhe të organizojë transportin deri në vendbanimin e tij.

### **V. RAPORT PËR REALIZIMIN E EKSKURSIONEVE, DALJEVE DHE AKTIVITETEVE TË TJERA JASHTËSHKOLLORE TË NXËNËSVE NGA SHKOLLAT FILLORE**

#### **Neni 31**

Menjëherë pas zbatimit të ekskursioneve, daljeve dhe aktiviteteve të tjera jashtëshkollore, ndërsa më së voni në afat prej shtatë ditëve, ekipi profesional paraqet raport me vlerësim për realizimin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara. Raporti shqyrtohet nga këshilli i mësimitdhënësve dhe këshilli i prindërve, dhe miratohet nga bordi i shkollës.

Raporti bëhet pjesë përbërse e raportit vjetor për punën e shkollës.

Udhëheqësi i klasave i njohin prindërit me raportin e mbledhjes së prindërve.

Nëse, pas shqyrtimit të raportit për realizimin e ekskursionit, daljes dhe aktiviteteve të tjera jashtëshkollore, vlerësohet se realizuesit e shërbimeve nuk i kanë përmbushur detyrimet e dakorduara, shkolla është e detyruar të njoftojë themeluesin.

## VI. MBIKËQYRJA

### Neni 32

Mbikëqyrja për realizimin të dispozitave të kësaj rregulloreje kryhet nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve të tij në përputhje me Ligjin për Inspektimin e Arsimit.

## VII. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

### Neni 33

Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, pushon së vlefshmi Rregullorja për mënyrën e kryerjes së ekskursioneve shkollore, daljeve dhe aktiviteteve të tjera jashtëshkollore të nxënësve të shkollave fillore nr. 12-13487/1 të datës 19.11.2019 dhe nr. 12-11297/1 të datës 15.10.2020.

### Neni 34

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme pas ditës së sjelljes së tij.

12-10853/1  
04.08.2025  
Број/Numër:  
Дата/Data:  
Скопје/Shkup



Министерка за образование и наука,  
Министре е Арсими и Шкенис  
проф. д-р Весна Јаневска